Pjesëmarrësit kanë konsideruar se rekomandimet e vitit 2011 janë të mira dhe realiste, por nuk kanë qenë të kënaqur me faktin se shumica e tyre nuk janë zbatuar. Në këtë aspekt, një numër pjesëmarrësish kanë propozuar që, pasi që qeveria e Serbisë nuk i ka pranuar rekomandimet si një udhërrëfyes dhe pasi që situata politike rreth çështjes së Kosovës ka ndryshuar dukshëm, ata do të duhej ta rishikonin tekstin dhe të dilnin me një grup të ri rekomandimesh.

Pjesëmarrësit janë pajtuar se ekziston mungesë e përpjekjeve për zbatimin e rekomandimeve. Ata kanë thënë se Beogradi nuk ka dashur t'i japë shumë rëndësi publike këtyre rekomandimeve. Për më shumë, pjesëmarrësit poashtu kanë thënë se serbët nga Kosova kanë mundur të bëjnë shumë më tepër në koordinimin e përpjekjeve dhe deklaratave të tyre.

Gjatë vitit 2012, pjesëmarrësit e projektit nuk kanë diskutuar vetëm se si gjendja aktuale ndikon në këto rekomandime, por edhe mënyrat se si të rishkruhen ato duke pasë parasysh një pikëpamje realiste të mundësive për implementimin e tyre. Ata kanë vënë theksin në faktin se nevojitet inkurajimi i një gatishmërie politike nga ana e politikanëve si në Beograd ashtu edhe në Prishtinë. Së këndejmi, një numër i madh i rekomandimeve në këtë tekst inkurajojnë një gatishmëri më të madhe politike në të dyja anët. Zbatimi i shumë rekomandimeve varet kryesisht nga vendosmëria politike, dhe jo edhe aq nga resurset financiare.

Duke adresuar procesin e implementimit, pjesëmarrësit kanë theksuar se vet ata duhet të bëjnë presion mbi ata të cilët duhet të zbatojnë rekomandimet si dhe t'u ndihmojnë atyre në gjetjen e qasjeve më të mira. Ata poashtu kanë thënë

se ata duhet të luajnë një rol më aktiv në procesin e implementimit, e jo vetëm në atë të dhënies së rekomandimeve.

Rekomandimet nuk janë bazuar në konsensus por në marrëveshje të gjëra të pjesëmarrësve në diskutim, prandaj jo çdo rekomandim mund t'i mvishet secilit pjesëmarrës. Pjesëmarrësit kanë marrë pjesë në këtë iniciativë në kapacitetin e tyre personal dhe mendimet e tyre jodomosdoshmërisht paraqesin ato të organizatave të cilat i përfaqësojnë. Rekomandimet do t'u dërgohen institucioneve të Serbisë e Kosovës, akterëve tjerë me influencë, si dhe përfaqësuesve ndërkombëtar, përgjegjës dhe të interesuar për zhvillimin e politikave që kanë të bëjnë me Kosovën.

## **SIGURIA DHE TË KTHYERIT**

**Siguria:** Pjesëmarrësit janë pajtuar se siguria e serbëve në Kosovë është ende e pamjaftueshme, por duhet theksuar se sfidat e sigurisë dallojnë mes komunitetit serb në veri dhe në jug të lumit Ibër. Në këtë moment, problemet e lidhura me krimin e organizuar dominojnë në veri, kurse incidentet ndëretnike janë sporadike. Në pjesën tjetër të Kosovës, problemet dominante përfshijnë të dyja, krimin e organizuar dhe incidentet ndëretnike. Së këndejmi, për shkak të këtyre sfidave të ndryshme të sigurisë, çështja e sigurisë në veri dhe në pjesën tjetër të Kosovës duhet të adresohet në mënyra të ndryshme. Ekziston një tendencë e përhapur nga të dyja palët që të politizohen krimet dhe incidentet para mbylljes së hetimeve nga policia. Pjesëmarrësit kanë tërhequr vërejtjen për këtë dhe kanë qenë fuqishëm kundër politizimit të krimeve dhe lënies së fajit komunitetit tjetër. Akuzat të tilla rezultojnë në rritjen e tensioneve ndëretnike.

1. **Efikasiteti i organizmave që janë përgjegjëse për garantimin e sigurisë së qytetarëve në veri – Policia e Kosovës (PK), Misioni Evropian i Sundimit të Ligjit (EULEX), dhe KFOR-i – duhet të përmirësohet.** Së këndejmi, në kuadër të dialogut Beograd-Prishtinë, është e nevojshme të adresohet çështja e dhënies së përgjegjësisë së plotë për sigurinë në veri PK-së. Është poashtu e nevojshme që në mënyrë aktive të përfshihet EULEX-i në punën e policisë, me qëllim të zbulimit dhe procesimit të të gjitha krimeve. Disa individë abuzojnë me vonesën e zgjidhjes së krimeve. Për këtë arsye, ky proces duhet të përshpejtohet.
2. **Gjyqësori i pranueshëm për të gjithë akterët (Prishtina, Beogradi dhe komuniteti ndërkombëtar) duhet të instalohet në veri urgjentisht.** Qëllimi është sundimi i ligjit dhe jeta normale për të gjithë qytetarët. Pa i dënuar përgjegjësit për kryerjen e krimeve, nuk është e mundur vendosja e sundimit të ligjit. Kuotat e punësimit për komunitetet etnike jo-shumicë, të ofruara nga ligji i Kosovës duhet të respektohen në krijimin e gjyqësorit.
3. **Institucionet që janë përgjegjëse për sundimin e ligjit duhet të**

**ngrisin kapacitetet e tyre profesionale për zgjidhjen e çështjeve të jashtëzakonshme.** Kryerësit e krimeve kundër anëtarëve të komunitetit serb në Kosovë duhet të gjenden dhe të dënohen. Me qëllim të ngritjes së efikasitetit në zgjidhjen e këtyre rasteve, përfshirja e më shumë serbëve brenda PK-së dhe gjyqësorit është e domosdoshme. Beogradi duhet ta mbështes këtë përfshirje. Udhëheqësit politik të të gjitha komuniteteve në Kosovë duhet të tregojnë gatishmëri të qartë politike për zgjidhjen e këtyre rasteve dhe për përfshirje më të gjërë të serbëve në institucionet e sundimit të ligjit.

4. **Fati i të gjithë të zhdukurve duhet të ndriçohet.** Prishtina, Beogradi dhe komuniteti ndërkombëtar duhet të vazhdojnë dhe të përfundojnë punën e tyre për ndriçimin e fatit të personave të zhdukur në Kosovë.

**Kthimi:** E drejta për tu kthyer është e drejtë njerëzore. Cdokush duhet të jetë në gjendje të kthehet dhe të rikërkojë pronën e tij. Prishtina, Beogradi dhe komuniteti ndërkombëtar duhet t'u mundësojnë të gjithë personave të zhvendosur, pavarësisht përkatësisë së tyre etnike, që të kthehen në shtëpitë dhe pronat e tyre. Rezultatet e kthimeve që nga përfundimi i luftës kanë qenë tepër të dobëta dhe shanset për më shumë të kthyer janë duke u zvogëluar. Mungesa e sigurisë, intimidimi i të kthyerve, gatishmëria e pamjaftueshme politike nga Prishtina e Beogradi për të përkrahur kthimin, dhe mungesa e mundësive ekonomike janë pengesat kyçe për kthim thelbësor.

1. **Institucionet e Kosovës dhe komuniteti ndërkombëtar duhet të angazhohen më shumë në sigurimin e një ardhmërie më të mirë për të kthyerit.** Kjo do të përbente një mesazh të qartë drejtuar të zhvendosurëve, se ekzistojnë kushtet për kthime të qëndrueshme në Kosovë. Kushtet për integrim të qëndrueshëm në shoqëri duhet të ofrohen për te kthyerit, duke krijuar vende pune për ta, duke ofruar shkollim, përkujdesje shëndetësore etj. Pronat e tyre duhet të mbrohen dhe të kthehen në pronësi të tyre duke përfshirë edhe rastet kur të tjerët kanë uzurpuar këto prona. Autoritetet lokale duhet të angazhohen më shumë në krijimin e mundësive të tilla, në qëndrueshmërinë e kthimeve dhe në krijimin e një atmosfere tolerante për të kthyerit në komunat e tyre. Qeveria e Kosovës duhet të ndajë fonde shtesë nga buxheti i saj për të mbështetur ata të cilët tashmë janë kthyer. Kjo nuk do të përmirësonte vetëm kushtet e jetesës për të kthyerit, por edhe do të bënte që ata të ndihen të mirëseardhur në Kosovë, si dhe do të dërgonte një mesazh të qartë se institucionet janë të vendosura në këtë proces.
2. **Institucionet e Kosovës, EULEX-i, dhe KFOR-i duhet të ofrojnë garanca shtesë të sigurisë për të kthyerit.** Të kthyerit ballafaqohen me një numër

sfidash, prej të cilave më seriozja është ajo e mungesës së sigurisë. Institucionet e Kosovës në bashkëpunim me EULEX-in dhe KFOR-in duhet të ngrisin nivelin e mbrojtjes. Organizmat përgjegjës duhet të reagojnë shpejtë dhe me efikasitet në rast të incidenteve dhe dhunës drejtuar të kthyerve dhe pronave të tyre. Politikanët në Prishtinë e Beograd duhet të bashkëpunojnë në krijimin e një atmosfere më të mirë dhe në përmirësimin e kushteve për të kthyerit.

## VERIU I KOSOVËS

Cështja e veriut të Kosovës mbetet sfidë serioze për Prishtinën, Beogradin dhe komunitetin ndërkombëtar, si dhe për serbët e Kosovës. Veriu është cështja e vetme më e veshitura me të cilën ballafaqohen kryeministrat e Kosovës e Serbisë në dialogun e sponsorizuar nga Brukseli. Pjesëmarrësit kanë definuar një numër cështjesh dhe kanë dhënë sugjerime për zgjidhjen e tyre. Ata nuk kanë qenë në gjendje të arrijnë konsensus për këto cështje. Disa pjesëmarrës, kryesisht nga veriu, kanë qenë në favor të vendosjes së një sistemi i cili do të ofronte hapësirë për vendimmarrje autonome për serbët në veri, ndërsa te tjerët, kryesisht nga jugu i lumit Ibër kanë thënë se cështja e veriut është pjesë e problemit të përgjithshëm të serbëve në Kosovë dhe duhet të trajtohet si e tillë.

1. Qeverisja lokale. Pjesëmarrësit nuk kanë qenë në gjendje të arrijnë konsensus rreth cështjes së vendosjes së institucioneve lokale të pranueshme për të gjithë akterët politik. Disa kanë thënë se institucionet lokale ekzistuese në veri janë legjitime dhe legale për Beogradin, dhe legjitime por ilegale për Prishtinën dhe komunitetin ndërkombëtar. Sido që të jetë, është propozuar që të gjithë akterët duhet t'i pranojnë këto institucione si organizma tranzicional. Disa pjesëmarrës kanë thënë se tranzicioni duhet të zgjasë derisa të ketë marrëveshje për të organizuar zgjedhjet lokale në veri. Brukseli ka bërë një hap para duke komunikuar në mënyrë të drejtpërdrejt me këto institucione, dhe në këtë kontekst, ai duhet ta inkurajojë Prishtinën ta bëjë të njejtën, kurse institucionet në veri të tregojnë gatishmëri më të madhe për të komunikuar dhe për të bashkëpunuar me Prishtinën, me qëllim të përmirësimit të jetërave të qytetarëve në veri. Së këndejmi, duhet të arrihet mirëkuptim i ndërsjellë mes Prishtinës, Beogradit dhe komunitetit ndërkombëtar, dhe institucioneve të tanishme lokale serbe në veri. Një numër i pjesëmarrësve, kryesisht nga veriu, kanë thënë se duhet krijuar Asociacioni i Komunave Serbe të Veriut dhe i njeiti duhet të ngritet në nivelin e entitetit special, me qëllim të transformimit të tij në parlament. Marrëdhëniet mes Asociacionit dhe Prishtinës do të rregulloheshin në negociata direkte mes tyre, me përkrahjen e Beogradit dhe ndërmjetësimin e komunitetit ndërkombëtar. Megjithatë, një numër i pjesëmarrësve, kryesisht nga pjesa

tjetër e Kosovës, kanë qenë kundër këtij propozimi, disa mjaft fuqimisht, duke thënë se një lëvizje e tillë jo vetëm që është jorealiste – nuk ka gjasa që Prishtina dhe komuniteti ndërkombëtar të pajtohen me ate – por, ajo mund edhe ti lëndojë interesat e serbëve në jug të lumit Ibër, ku aktualisht jetojnë dy të tretat e serbëve në Kosovë. Ata frigohen se krijimi i një entiteti të tillë special do të jetë i dëmshëm për të drejtat e tyre të tanishme.

2. **Siguria.** Sa i përket sigurisë në veri, është thënë se PK-ja nuk është duke funksionuar me kapacitete të kënaqshme. Një numër pjesëmarrësish nga veriu kanë thënë se Prishtina, Beogradi dhe komuniteti ndërkombëtar duhet të punojnë në integrimin anëtarëve të strukturave të ndryshme të sigurisë në veri, në një trupë të vetme rajonale policore. Një organizatë e një niveli të tillë rajonal, pjesë e propozimit për Asociacionin e Komunave Serbe në Veri, duhet të lidhet në mënyrë horizontale me qëllim të koordinimit me Ministrinë e Punëve të Brendshme të Kosovës. Ky proces duhet të përfundojë para largimit të strukturave serbe në veri të Kosovës. Pjesëmarrësit e tjerë, megjithatë, kanë thënë se niveli i të drejtave dhe organizimit të policisë në veri duhet të jenë të njëjta si në tërë Kosovën. Në të kundërtën, kjo mund të ndikojë negativisht në të drejtat e tyre dhe në efikasitetin e policisë në tërë Kosovën.
3. **Gjyqësori.** Në veri të Kosovës, sistemi ligjor i Kosovës nuk implementohet dhe sistemi ligjor i Serbisë nuk respektohet në tërësi, duke krijuar kështu një vakum të plotë ligjor. Një sistem funksional ligjor duhet të vendoset. Për shembull, në lidhje me krimet e ndryshme policia thotë se ata i kanë provat, por se gjykatat lokale nuk kanë as kapacitete e as juridiksion për ti ndjekur kryesit e krimeve. Pasiqë nuk është e mundur të procesohen krimet me kapacitetet e tanishme gjyqësore, koordinimi mes të gjitha institucioneve duhet të vendoset përmes dialogut që po zhvillohet në Bruksel. Prishtina dhe Beogradi duhet të gjejnë një zgjidhje rreth kornizës ligjore që duhet të përdoret në veri. Pjesëmarrësit kanë thënë se gjyqësori duhet të jetë i pavarur. Reforma e gjyqësorit në veri duhet të bëhet nga gjykatat e Kosovës, duke filluar nga trupat më të lartë gjyqësor përmes monitorimit dhe përfshirjes së gjyqtarëve të EULEX-it. Gjykatat në veri duhet të përbëhen nga gjykatës prej popullatës lokale me pjesëmarrjen dhe monitorimin e gjyqtarëve ndërkombëtarë. Përkrahja e komunitetit ndërkombëtar është e nevojshme në financimin e strukturës së tanishme të gjyqësorit, deri në nivelin e gjykatave komunale dhe atyre rajonale.
4. **Shëndetësia dhe edukimi.** Sistemi i edukimit dhe ai shëndetësor në veri të Kosovës duhet të funksionojnë si pjesë e sistemit të edukimit dhe shëndetësisë së Serbisë. Një marrëveshje për këtë duhet të arrihet në vitin 2013, përmes dialogut mes Prishtinës e Beogradit, i cili po zhvillohet



## KOMUNITETI NDËRKOMBËTAR

Komuniteti ndërkombëtar vazhdon të luajë një rol të rëndësishëm në ofrimin e sigurisë për serbët në Kosovë. Pjesëmarrësit kanë propozuar që komuniteti ndërkombëtar në Kosovë, sic janë EULEX-i dhe KFOR-i, duhet të angazhohen më tepër në përmirësimin e sigurisë për të gjithë serbët në Kosovë – si në veri, ashtu edhe në jug të lumit Ibër, dhe të ushtrojë tryzni mbi Prishtinën që t'i implementojë në plotni ligjet e saja në raport me serbët, veçanërisht në komunat me popullsi shumicë serbe. Pjesëmarrësit poashtu kanë thënë se komuniteti ndërkombëtar duhet ta rrisë komunikimin me serbët në Kosovë për tu njohur me problemet me të cilat ballafaqohen ata. Sa u përket serbëve, një nga organizatat më të rëndësishme ndërkombëtare në Kosovë është EULEX-i. Pjesëmarrësit kanë thënë se misioni duhet të bëjë më shumë në luftimin e kimit të organizuar dhe në krijimin e një atmosfere të sigurtë për të gjitha komunitetet.

1. **Komuniteti ndërkombëtar dhe të drejtat e njeriut në Kosovë.** EULEX-i, KFOR-i, OSBE-ja, UNMIK-u, organizatat tjera të KB-së, Këshilli i Evropës dhe misionet diplomatike në Prishtinë përfaqësojnë komunitetin ndërkombëtar në Kosovë. Komuniteti ndërkombëtar duhet të bëjë më shumë në mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Kosovë, në pajtim me kornizat ligjore ekzistuese të Kosovës dhe ato ndërkombëtare. Prishtina, Beogradi dhe serbët në institucionet e Kosovoës dhe ato të Serbisë, si dhe organizatat joqeveritare duhet të rrisin bashkëpunimin me komunitetin ndërkombëtar rreth kësaj çështjeje.
2. **Komuniteti ndërkombëtar duhet të insistojë në implementimin e të gjitha ligjeve të Kosovës të cilat kontribuojnë në përmirësimin e përgjithshëm të gjendjes së serbëve në Kosovë.** Përfaqësuesit serbë në institucionet e Kosovës, si dhe përfaqësuesit serbë në institucionet e Serbisë duhet që drejtpërdrejt apo përmes kontakteve të tyre me përfaqësuesit e komunitetit ndërkombëtar, të ndikojnë në qeverinë e Kosovës për zbatimin e të gjitha ligjeve të Kosovës të cilat kontribuojnë në përmirësimin e gjendjes së serbëve në Kosovë. Kjo në vecanti ka të bëjë me ligjet të cilat lidhen me lirinë e lëvizjes, punësimin, eliminimin e plotë të diskriminimit gjuhësor (e drejta për ta përdorur gjuhën e folur dhe të shkruar), dhe forcimin e sektorit medial në gjuhën serbe, si dhe krijimin e kushteve të barabarta për punësim, shkollim dhe shëndetësi.
3. **Komuniteti ndërkombëtar duhet ta lehtësojë një komunikim dhe bashkëpunim më të madh mes serbëve e shqiptarëve në Kosovë, në sferën private dhe ate publike.** Kjo mund të arrihet përmes aktiviteteve të cilat

promovojnë shkëmbimin e opinioneve mes politikanëve, përfaqësuesve të shoqërisë civile, grave dhe të rinjve nga të dyja komunitetet, si dhe përmes lehtësimit të dialogut në nivele të ndryshme mes Beogradit e Prishtinës. Pjesëmarrësit besojnë se shëndrrimi i komunikimit ndëretnik dhe bashkëpunimit në një zhvillim normal është çelësi për ndërtimin e një shoqërie funksionale dhe tolerante.

4. **Komuniteti ndërkombëtar duhet ta garantojë funksionimin e institucioneve shërbyese të Serbisë.** Institucionet shërbyese të Serbisë – edukimi dhe shëndetësia – janë të një rëndësie vitale për komunitetin serb. Ato duhet të funksionojnë të papënguar, përveç nëse, apo derisa një marrëveshje për ta ndërruar statusin e tyre të arrihet mes Prishtinës e Beogradit. Disa serbë frigohen se Prishtina mund të ushtrojë tryzni me qëllim të mbylljes së këtyre institucioneve. Komuniteti ndërkombëtar duhet të garantojë që puna e këtyre institucioneve të vazhdojë e papënguar.

## INSTITUCIONET E KOSOVËS

Institucionet e Kosovës janë njohur nga pjesa më e madhe e serbëve në jug të lumit Ibër, por ato bojkotohen nga serbët në veri, të cilët kanë institucionet e tyre të njohura si institucione të Serbisë apo paralele. Institucionet e Kosovës kanë implementuar pjesën më të madhe të dispozitave të planit të Ahtisaarit në jug, përfshirë edhe krijimin e komunave të reja me shumicë serbe, si dhe kanë përfshirë përfaqësues serbë në koalicionin qeveritar, duke u dhënë atyre tri ministri dhe një zëvendës kryeministër. Komunitat e reja në jug janë duke funksionuar relativisht mirë dhe ofrojnë shërbimet e nevojshme për komunitetin serb.

Pjesëmarrësit janë pajtuar që institucionet e Kosovës kanë shënuar progres në përmirësimin e jetës së serbëve, por kanë thënë se ato duhet të bëjnë më shumë për ta fituar besimin e komunitetit serb. Disa pjesëmarrës kanë thënë se plani i Ahtisaarit në jug duhet të zbatohet në plotni. Ky do të ishte mesazhi më i mirë për t'u treguar të gjithë serbëve në Kosovë se institucionet e Kosovës janë për integrim, për forcimin e bashkëjetesës dhe për krijimin e besimit. Ata poashu kanë thënë se krimet kundër serbëve dhe rastet e pronave që lidhen me komunitetin serb, duhet të zgjidhen më shpejtë me qëllim të përmirësimit të situatës së serbëve dhe kredibilitetit të institucioneve të Kosovës në sytë e serbëve.

1. **Institucionet e Kosovës duhet të përmirësojnë kushtet e jetesës për serbët.** Pikë së pari, ato duhet sipas mundësive të fokusohen në përmirësimin e prospektit ekonomik për këtë komunitet. Poashtu është e rëndësishme të krijohen kushtet për ruajtjen e identitetit kombëtar përmes rrespektimit të plotë të ligjeve mbi përdorimin e gjuhës dhe shkrimit, simbolet nacionale, kulturën dhe edukimin. Prishtina duhet t'i implementojë të gjitha ligjet e

saja, veçanërisht në transferimin e kompetencave tek institucionet lokale. Transferimi i kompetencave do ta përmirësojë qeverisjen lokale, dhe në komunat me shumë serbe do ta ndërtojë besimin e ndërsjellë. Komuniteti ndërkombëtar, serbët e Kosovës, dhe organizatat joqeveritare serbe si dhe mediat, duhet të ushtrojnë trysni shtesë mbi Prishtinën që t'i respektojë plotësisht ligjet që kanë të bëjnë me komunitetet jo-shumicë.

2. **Përfaqësimi i mjaftueshëm i serbëve (nga veriu dhe jugu) në të gjitha institucionet dhe proceset politike në Kosovë duhet të garantohet.** Ulëset e rezervuara në parlamentin e Kosovës për komunitetin serb, duhet të ruhen. Në këtë aspekt, komuniteti ndërkombëtar dhe serbët në institucionet e Kosovës luajnë një rol kyç. Organizatat joqeveritare serbe do të mund të kontribuonin në këtë drejtim gjithashtu. Sipas planit të Ahtisaarit, ulëset e rezervuara për komunitetin serb janë lejuar vetëm për dy mandatet e para pas aprovimit të planit. Megjithatë, pjesëmarrësit kanë thënë se, duke marrë parasysh kushtet e vazhdueshme të vështira për serbët, kjo e drejtë duhet të vlejë edhe për dy mandate tjera, dhe në afat më të gjatë, të bëhet e përhershme.
3. **Duhe të bëhet një analizë e procesit të decentralizimit në Kosovës.** Institucionet e Kosovës përgjegjëse për qeverisjen lokale, në bashkëpunim me serbët e institucioneve qendrore e lokale duhet ta bëjnë një analizë të implementimit të procesit të decentralizimit dhe të përpjekjeve për forcimin e qeverisjes lokale. Analiza duhet të tregojë se cilat kompetenca janë transferuar tek institucionet lokale, e cilat jo, dhe arsytet për këtë.
4. **Forcimi i qëndrueshmërisë së popullatës serbe në Kosovë.** Institucionet në Kosovë duhet të krijojnë mundësi politike dhe ekonomike për mbijetesën e komunitetit serb. Karakteri multietnik i Kosovës duhet të ruhet. Është e nevojshme të adoptohen masa për ruajtjen e popullatës serbe në Koovë, veçanërisht në komunat me shumicë serbe. Në këtë kontekst, roli i institucioneve lokale në komunat me shumicë serbe, duhet të fuqizohet në vendimmarrje rreth çështjeve lokale, siç është privatizimi i qendres së skijimit në Brezovicë (në komunën e Shtërpces), që do të krijojë një numër të madh të vendeve të punës për popullatën serbe në këtë pjesë.
5. **Institucionet e Kosovës duhet të përkrahin pjesëmarrjen e serbëve në jetën politike dhe publike.** Institucionet e Kosovës duhet të përkrahin pjesëmarrjen e serbëve në jug pasi që ata paraqesin dy të tretat e komunitetit serb në Kosovë, por poashtu pasi që shërben si një shembull i mirë i bashkëjetesës shqiptaro-serbe dhe bashkëqeverisjes, dhe do të mund të përmirësonte marrëdhëniet e përgjithshme mes dy shoqërive. Duke abstenuar nga përdorimi i dhunës me qëllim të vendosjes së autoritetit në veri, përpos kur ekziston pajtimi mes të gjitha palëve, dhe nga retorika

e ashpër kundrejt serbëve në veri, qeveria e Kosovës duhet të angazhohet aktivisht me të gjithë përfaqësuesit e zgjedhur politik të serbëve të veriut.

## POLITIKAT E SERBËVE NË KOSOVË

Komuniteti serb në Kosovë mbetet i ndarë mes serbëve në jug dhe atyre në veri. Duke marrë parasysh rrethanat e ndryshme, disa pjesëmarrës kanë thënë se atyre duhet qasur me politika të ndryshme nga Prishtina, Beogradi dhe komuniteti ndërkombëtar. Megjithatë, disa tjerë kanë thënë se serbët në Kosovë duhet të trajtohen si një komunitet i vetëm dhe se të bashkuar mund të arrijnë më shumë. Ata poashtu kanë sugjeruar përfshirjen e jo-politikanëve në këto përpjekje, vecanërisht të më shumë grave dhe të rinjëve serbë të Kosovës. Shumë pjesëmarrës kanë thënë se përfshirja e serbëve në çështjet të cilat nuk merren drejtpërdrejt me komunitetin e tyre, siç janë privatizimi dhe reforma ligjore, është kyçe për ardhmërinë e qëndrueshme të tyre në Kosovë. Por shumë pjesëmarrës kanë theksuar se dallimet mes serbëve në veri dhe atyre në jug do të mbeten të tilla deri në gjetjen dhe implementimin e një zgjidhjeje për veriun.

1. **Partitë politike serbe duhet të vendosin bashkëpunim më të madh.** Partitë politike serbe duhet t'i harmonizojnë politikat e tyre dhe të veprojnë si një aleancë politike fleksibile, sidomos në çështjet që janë me interes të veçantë për komunitetin serb. Një harmonizim i tillë, jo vetëm që do të promovojë kohezionin politik e social, por poashtu do të forcojë fuqinë e të bërit pazar të komunitetit serb në politikën e Kosovës. Bashkëpunimi në çështjet kyçe duhet të vendoset mes të gjithë anëtarëve serbë të parlamentit të Kosovës, pavarësisht përkatësisë partiake. Duhet krijuar kushtet që të gjitha partitë serbe të jenë në gjendje të bashkëpunojnë të papënguar në tërë territorin e Kosovës. Partitë politike serbe duhet të vendosin bashkëpunim më aktiv me përfaqësuesit e komunitetit ndërkombëtar në Kosovë.
2. **Serbët në Kosovë duhet të angazhohen në çështje të përgjithshme.** Partite serbe duhet të angazhohen në çështje joetnike – privatizimi, buxheti i Kosovës, zhvillimi ekonomik, reforma qeverisëse, lufta kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, sundimi i ligjit, reforma kushtetuese, dhe reforma zgjedhore – të cilat kanë pasoja për të gjithë banorët e Kosovës. Interesat e komunitetit serb dhe komuniteteve tjera janë në pajtim me shumë nga këto çështje.
3. **Beogradi duhet ta përkrahë pjesëmarrjen politike të serbëve.** Beogradi duhet ta njohë vendimin e serbëve për të marrë pjesë në institucionet e Kosovës. Beogradi duhet haptazi ta përkrah një pjesëmarrje më të gjërë të serbëve në zgjedhjet e Kosovës në mënyrë që të forcohet pozita e serbëve

në institucionet e Kosovës, dhe në vendimmarrje.

4. **Debati publik në veri duhet të demonopolizohet.** Një atmosferë tolerante duhet të krijohet për publikun që të debatojë pozitën dhe pikëpamjet e ndryshme rreth çështjeve politike dhe jopolitike, të cilat i preokupojnë serbët që jetojnë në veri të Kosovës. Në këtë moment, një grup i vogël i njerëzve dominojnë debatin rreth proceseve politike në veri të Kosovës. Shumë pjesëmarrës kanë thënë se ata të cilët përkrahin radikalët e dominojnë debatin dhe se më shumë hapësirë duhet t'u jepet atyre që përkrahin pozicione dhe zgjidhje më të moderuara.
5. **Prishtina, Beogradi dhe komuniteti ndërkombëtar duhet të punojnë në krijimin e mundësive për përfshirjen e të rinjëve dhe njerëzve të rinj në proceset politike.** Është e nevojshme të krijohen më shumë mundësi për përfshirjen e të rinjëve dhe individëve të rinj nga komuniteti serb, në procesin politik në Kosovë, për të promovuar qasje të reja për zgjidhjen e çështjeve të ndryshme. Shumica prej tyre u ikin angazhimit politik sepse e shohin politikën si një profesion të korruptuar të dominuar nga grupet e interesit, dhe jo si mjet për të përmirësuar interesin publik. Një përpjekje duhet të bëhet për të motivuar këta njerëz pasiv që ta marrin parasysh angazhimin politik si një mundësi për përmirësimin e kushteve të tanishme në të cilat jeton popullata serbe në Kosovë.
6. **Institucionet e Kosovës duhet të krijojnë më shumë mundësi për përfshirjes e grave serbe në jetën publike.** Nevojitet krijimi i më shumë mundësive për përfshirjen e grave serbe në procesin politik, përfshirë pozitën udhëheqëse të partive politike, mediave, dhe institucioneve publike e private. Rekomandohet veprimi afirmativ në të gjitha nivelet e qeverisë dhe ndërmarrjeve publike. Megjithatë, ky do të ishte vetëm hapi i parë, pasi që gratë duhet poashtu të përkrahen në përmirësimin e obligimeve të tyre në këto pozita, duke pasur kështu një qasje proaktive si për obligimet, ashtu edhe për pyetjet e rëndësishme për komunitetin.

## **BEOGRADI DHE SERBËT NË KOSOVË**

Pas shpalljes së pavarrësisë së Kosovës në vitin 2008, Beogradi pat ndërprerë komunikimin me Prishtinën, organizoi zgjedhje lokale në Kosovë dhe vendosi institucionet e veta atje. Që nga ajo kohë, Beogradi ka bërë disa ndryshime maadhore të politikave: ka filluar dialogun dhe ka arritur dhe implementuar një numër marrëveshjesh me Prishtinën; nuk ka organizuar zgjedhje lokale në Kosovë në vitin 2012; dhe është angazhuar në gjetjen e zgjidhjes për veriun brenda Kosovës, pa e njohur pavarësinë e saj. Përkundër këtyre ndryshimeve

në politika, shumë serbë në Kosovë thonë se Beogradi nuk konsultohet me ta aq sa duhet në lidhje me çeshtjet të cilat janë kryesore për ta. Ata rekomandojnë që Beogradi duhet t'i konsultojë më shpesh dhe t'a marrë parasysh gjendjen e komunitetit serb, kur merret me ndërtimin e politikave për Kosovën.

1. **Beogradi dhe anëtarët serbë të parlamentit të Kosovës duhet të vendosin bashkëpunimin.** Udhëheqësia e Serbisë duhet të vendosë komunikim të hapur dhe bashkëpunim me anëtarët serbë në parlamentin e Kosovës, dhe në mënyrë graduale ta formalizojnë marrëdhënien mes tyre. Beogradi nuk e njeht pavarësinë e Kosovës, por është përfshirë në dialog direkt me qeverinë e tij, nën strategjinë e "angazhimit pa njohje". Beogradi nuk e njeht pavarësinë e Kosovës, por është angazhuar në dialogun e drejtpërdrejt me qeverinë e cila operon me strategjinë e "angazhimit pa njohje". Strategjia e njëjtë mund të aplikohet edhe me partitë parlamentare serbe në Kosovë.
2. **Beogradi duhet të përfshijë të gjithë përfaqësuesit e zgjedhur serb në Kosovë, në bërjen e politikave rreth Kosovës dhe në dialogun me Prishtinën.** Politikat e Beogradit për Kosovën duhet të definohet qartazi, të jenë pragmatike dhe fleksibile, si dhe të marrin parasysh kontributin rreth politikave nga të gjithë përfaqësuesit e zgjedhur serbë në Kosovë, pavarësisht përkatësisë së tyre partiake apo institucionale. Ata duhet të jenë pjesë e bërjes së politikave dhe faktor kyç në procesin e implementimit të politikave. Kjo mund të arrihet me formimin e një trupi këshillues, përfshirë zyrtarë të qeverisë dhe presidencës së Serbisë, politikanë të zgjedhur nga të gjitha partitë politike që përfaqësojnë serbët e Kosovës dhe anëtarët e shoqërisë civile të serbëve të Kosovës.
3. **Beogradi duhet ta rrisë transparencën dhe efikasitetin e fondeve të tij dedikuar Kosovës.** Beogradi duhet të jetë më transparent, efikas, dhe llogaridhënës me menaxhimin e fondeve të Serbisë dedikuar serbëve të Kosovës. Një pjesë më e madhe e fondeve duhet të ndahen për edukim, shëndetësi dhe zhvillim ekonomik. Beogradi gjithashtu duhet ta rregullojë sistemin e vet të kontributeve shoqërore të aplikuar në Kosovë. Duhet ta bëjë diversifikimin e këtyre burimeve me qëllim të rritjes së aktivitetit ekonomik në pjesë e banuara me serbë, me qëllim të ngritjes së vendeve të punës në sektorin privat. Edhe Beogradi e edhe serbët pjesëmarrës në institucionet e Kosovës duhet të krijojnë një regjistër të punëve të kërkuara më së shumti për të pasë zhvillim të mëtejshëm të ekonomisë dhe shoqërisë përbrenda komunitetit serb në Kosovë. Ky regjistër duhet të përdoret për ta drejtuar më mirë shkollimin dhe procesin e rikualifikimit të punëtorëve.
4. **Beogradi duhet të vazhdojë asistencën e tanishme sociale për serbët në Kosovë.** Derisa të vendoset një bazë ekonomike, pagesat sociale të qeverisë së Serbisë për serbët në Kosovë duhet të vazhdojnë. Ato janë qenësore për

ekzistencën e tyre. Në ndërkohë, serbët së bashku me qeveritë e Serbisë e Kosovës duhet t'i përkrahin iniciativat që promovojnë aktivitet ekonomik.

5. **Beogradi dhe institucionet lokale në komunat me shumicë serbe në Kosovë duhet të vendosin bashkëpunimin.** Beogradi duhet ta vendosë komunikimin dhe bashkëpunimin me autoritetet komunale të komunave me shumicë serbe në Kosovë. Tashmë që Beogradi ka filluar dialogun me autoritetet e Kosovës, injorimi i autoriteteve lokale të serbë të Kosovës është joefikas. Ky bashkëpunim do të mund të fillonte me bashkëfinancim të projekteve infrastrukturore në komuna. Ai poashtu do të prodhojë një përdorim më racional të burimeve financiare të cilat Beogradi aktualisht i shpenzon në serbët e Kosovës, si dhe përdorim më të mençur të resurseve të kufizuara në mesin e serbëve të Kosovës.
6. **Beogradi duhet t'i normalizojë marrëdhëniet me Prishtinën.** Beogradi duhet të luajë një rol konstruktiv në angazhimin e tij me Prishtinën dhe t'i normalizojë marrëdhëniet. Marrëdhëniet e mira mes Beogradit e Prishtinës do të pasqyrohen në marrëdhëniet e përmirësuara mes serbëve të Kosovës dhe shqiptarëve të Kosovës. Një normalizim i vërtetë i marrëdhënieve mes Prishtinës e Beogradit duhet të përkthehet në përmirësime reale në jetërat e të gjithëve që jetojnë në Kosovë.





## PARTICIPANTS | UČESNICI | PJESËMARRËSIT\*\*

### **Saša Đokić**

Serb Democratic Party  
of Kosovo and Metohija  
Srpska demokratska stranka  
Kosova i Metohije  
Partia Demokratike Serbe  
e Kosovës dhe Metohisë

### **Marija Gavrić**

NGO "Mother of Nine Jugovics"  
NVO "Majka devet Jugovića"  
OJQ "Nëna e Nëntë Jugoviqëve"

### **Oliver Ivanović**

Civic Initiative "Serbia, Democracy, Justice"  
Građanska inicijativa  
"Srbija, Demokracija, Pravda"  
Inicijativa qytetare  
"Serbia, Demokracia, Drejtësia"

### **Dušan Janjić**

Forum for Ethnic Relations  
Forum za etničke odnose  
Forumi për Marrëdhënie Etnike

### **Dalibor Jevtić**

Independent Liberal Party  
Samostalna liberalna stranka  
Partia e Pavarur Liberale

### **Ljiljana Kenić**

United Serb List  
Jedinstvena srpska lista  
Lista e Bashkuar Serbe

### **Dragiša Krstović**

Liberal Democratic Party  
Liberalno-demokratska partija  
Partia Liberal Demokratike

### **Petar Miletić**

Independent Liberal Party  
Samostalna liberalna stranka  
Partia e Pavarur Liberale

### **Jelena Milić**

Center for Euro-Atlantic Studies  
Centar za evroatlantske studije  
Qendra për studime Euro-Atlantike

### **Smiljana Milisavljević**

Democratic Party  
Demokratska stranka  
Partia Demokratike

### **Smiljka Milisavljević**

University in Mitrovica  
Univerzitet u Mitrovici  
Universiteti në Mitrovicë

### **Ivana Milosavljević**

UNICEF

### **Dragan Nikolić**

United Regions of Serbia  
Udruženi regioni Srbije  
Rajonet e Bashkuara të Serbisë

### **Randel Nojkić**

Serbian Renewal Movement  
Srpski pokret obnove  
Lëvizja e Ripërtirjës Serbe

### **Veljko Odalović**

Socialist Party of Serbia  
Socijalistička partija Srbije  
Partia Socialiste e Serbisë

\*\* These participants took part in one or more meetings of the project. They participated in their personal capacities. Their institutional affiliations are given here for identification purposes only. This list does not imply full endorsement of all or any individual recommendation by every participant. Recommendations were not based on consensus but on broad agreement of the participants in the discussions, thus not every recommendation can be directly tied to every participant.

Ovi učesnici su učestvovali na jednom ili više susreta tokom projekta. Učestvovali su u svojem ličnom kapacitetu. Institucionalna pripadnost je data isključivo zbog lakše identifikacije. Ova lista ne sugerise da svi učesnici stoje, odnosno u potpunosti podržavaju, iza svih ili svake pojedinačne preporuke. Preporuke se ne zasnivaju na konsenzusu nego na širokom dogovoru učesnika u diskusiji, tako da nije moguće svaku od preporuka direktno povezati sa svakim učesnikom.

Këta pjesëmarrës kanë marrë pjesë në një apo më shumë takime të projektit. Ata kanë marrë pjesë në kapacitetet e tyre personale. Përkatesia e tyre institucionale është dhënë vetëm për arsye të identifikimit. Kjo listë nuk nënkupton mbështetje të plotë të të gjitha rekomandimeve, apo njërit prej tyre, nga secili pjesëmarrës. Rekomandimet nuk janë bazuar në konsensus, por në pajtim të gjërë mes pjesëmarrësve në diskutim, dhe së këndejmi, jo çdo rekomandim mund t'ivishet një pjesëmarrësi të caktuar.

**Zoran Ostojić**

Liberal Democratic Party  
Liberalno-demokratska partija  
Partia Liberal Demokratike

**Krstimir Pantić**

Serbian Progressive Party  
Srpska napredna stranka  
Partia Progresive Serbe

**Stojanka Petković**

United Regions of Serbia  
Udruženi regioni Srbije  
Rajonet e Bashkuara të Serbisë

**Dejan Radenković**

Socialist Party of Serbia  
Socijalistička partija Srbije  
Partia Socialiste e Serbisë

**Nenad Radosavljević**

Independent Network of Serb TV Stations  
Nezavisna mreža srpskih TV stanica  
Rrjeti i pavarrur i TV stacioneve serbe

**Živojin Rakočević**

*Glas Juga*

**Anamari Repić**

Radio Television of Kosovo  
Radiotelevizija Kosova  
Radiotelevizioni i Kosovës

**Vesimir Savić**

United Serb List  
Jedinstvena srpska lista  
Lista e Bashkuar Serbe

**Predrag Simić**

University of Belgrade  
Univerzitet u Beogradu  
Universiteti i Beogradit

**Sanja Sovrlić**

Independent Network of Serb TV Stations  
Nezavisna mreža srpskih TV stanica  
Rrjeti i pavarrur i TV stacioneve serbe

**Aleksandar Stojanović**

Center for the Development  
of Local Communities  
Centar za razvoj lokalnih sredina  
Qendra për Zhvillimin e  
Komuniteteve Lokale

**Momčilo Trajković**

Serbian Resistance Movement  
Srpski pokret otpora  
Lëvizja e Rezistencës Serbe

**Rada Trajković**

United Serb List  
Jedinstvena srpska lista  
Lista e Bashkuar Serbe

**Jelena Trivan**

Democratic Party  
Demokratska stranka  
Partia Demokratike

**Danijela Vujičić**

United Regions of Serbia  
Udruženi regioni Srbije  
Rajonet e Bashkuara të Serbisë

CIG

Council  
for Inclusive  
Governance

## **Council for Inclusive Governance**

---

### BOARD

**Steven L. Burg** (Chairman)

Brandeis University

**Gordon N. Bardos**

Association for the Study of Nationalities

**Michael W. Elf**

Macmillan Publishers

**Alex N. Grigorev**

Council for Inclusive Governance, Arcadia University

### STAFF

**Alex N. Grigorev**, President

**Shpetim Gashi**, Vice President

**Robert K. Aitkens**, Accountant

**Arber Kuci**, Associate

**Igor Novakovic**, Associate

**Marija Govedarica**, Associate

# CIG

Council  
for Inclusive  
Governance

The Council for Inclusive Governance (CIG) is an international nonprofit, nonpartisan, and non-governmental institution that promotes inclusive and responsive governance. It facilitates constructive dialogue as a means of fostering interparty cooperation, interethnic accord, and interstate collaboration, and carries out analyses of contemporary policy issues. The goal of CIG activities is to build confidence in democratic institutions of governance and contribute to the cohesiveness of political systems and societies.

CIG is supported by the Swiss Federal Department of Foreign Affairs, the British Foreign and Commonwealth Office, the Foundation for an Open Society, the Balkan Trust for Democracy of the German Marshall Fund of the United States and private contributions.

#### CIG activities include:

- Conducting innovative and transparent policy dialogues for major stakeholders;
- Facilitating interstate cooperation through international dialogues and exchange of experience;
- Promoting cooperation and consensus on national issues through dialogues between government and opposition;
- Supporting multiethnic states and strengthening common democratic institutions by facilitating consensus-building on issues that divide ethnic communities;
- Fostering trust and inclusive approaches in decision making;
- Providing informed advice and policy analysis;
- Publishing analytical reports and policy papers to advance public understanding of inclusive governance.

#### Council for Inclusive Governance

[cig@cigonline.net](mailto:cig@cigonline.net)

Online at  
[cigonline.net](http://cigonline.net)

#### Project supported by



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

**Federal Department of Foreign Affairs FDFA**